URDHËR
Nr. 626, datë 27.8.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, znj. Eugena Tomini, zëvendësministër, për:

a) emërimin dhe lirimin e drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorit të DQOSHKSH-së, drejtorëve të DROSHKSH-së dhe drejtorëve të drejtorive të DQOSHKSH-së;

b) emërimin, lirimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të spitaleve universitare, terciare, rajonale, bashkiake dhe ditore;

c) emërimin, lirimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucioneve të tjera qendrore në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

2. Ky delegim kompetence është i vlefshëm deri në revokimin e tij me shkrim nga titullari i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ose deri në përfundimin e mandatit të znj. Eugena Tomini, zëvendësministër.

3. Çdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala